

Tiranë, më 14.11.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje karburanti”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (F.P.P.):

- 09134100-8 (Karburant Diesel);
- 09132100-4 (Benzinë pa Plumb).

Vlera e fondit limit: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **20 144 280** (njëzet milion e njëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë) **Lekë pa TVSH** ose **208 446.61** (dyqind e tetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e një) **Euro pa TVSH**. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14/11/2025 është 96.64 Lekë/Euro.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake

në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit** të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet

ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë certifikimet sipas standardeve ndërkombëtare:

- a. Operatori ekonomik ofrues duhet të jetë i pajisur me **Certifikatën ISO 9001: 2015**, ose ekuivalente, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme, akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Operatori ekonomik ofrues duhet të jetë i pajisur me **Certifikatën ISO 14001: 2015**, ose ekuivalente, lidhur me sistemet e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme, akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001:2015 “Për menaxhimin e sistemit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme) është standard ndërkombëtar që garanton se operatori ekonomik zbaton një sistem menaxhimi cilësie që përmirëson vazhdimisht proceset. Kërkesa për këtë çertifikatë siguron që shërbimet ose produktet e kontratës do të përmbushin standarde të larta cilësie dhe do të kryhen me efikasitet.*

ISO 14001:2015, “Lidhur me sistemet e menaxhimit të mjedisit” është një seri normash dhe standardizimesh ndërkombëtare që i referohen sistemit të menaxhimit të mjedisit që është një standard që përcakton faktorët mjedisorë në proces nga lënda e parë tek klienti dhe kontrollon këta faktorë me masat e nevojshme dhe minimizon dëmtimin e mjedisit. ISO 14001, është një sistem i menaxhimit i zhvilluar për të reduktuar sistematikisht dhe, kur është e mundur të eliminojë dëmet që bizneset mund të shkaktojnë ose shkaktojnë në mjedis.

Sqarojmë se Albcontrol, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë në përputhshëmri me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit Europian si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative. Kërkesa për çertifikime sipas standardeve ISO janë ne vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përdorim të paktën 1 (një) Stacion Furnizimi me karburant me tollon në secilën nga vendodhjet e mëposhtme e vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kjo kërkesë duhet vërtetuar me një nga format e disponimit, sipas Kodit Civil (kontratë qiraje, kontratë furnizimi (bashkëpunimi) ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin tregtar të shoqërisë etj), për këto stacione që ndodhen në;

- Qytetin e Tiranës,
- Segmentin rrugor ish-Sheshi Shqiponja – Rinas dhe anasjelltas,
- Segmentin rrugor Rinas - Durrës dhe anasjelltas,
- Segmentin rrugor Milot - Lezhë dhe anasjelltas,
- Qytetin e Kukësit,
- Qytetin e Lushnjës,
- Qytetin e Fierit,
- Qytetin e Vlorës,
- Qytetin e Sarandës,
- Qytetin e Gjirokastrës.

Argumentim: Në bazë të pikës 4 të nenit të 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik, të ndryshuar, dhe nenit 40 pika 5/ç të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknike për realizimin e kontratës që konsiston në disponimin e stacioneve të tregëtimit të karburantit duke qënëse objekti i kontratës është furnizimi me karburant i automejeteve të A.K. gjatë lëvizjes së tyre në territor.

2.3.4 Të gjitha stacionet e tregëtimit me pakicë të karburanteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- a) Licencën lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë, objekt prokurimi,
- b) leje mjedisore të tipit B/C (sipas shtojcës 1 të ligjit 52/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar) Veprimtaria: Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B - Të gjitha instalimet),
- c) Vërtetim Teknik të lëshuar Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (O.M.V.K.),
- d) Çertifikate e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga M.Z.SH, dhe,
- e) Policë siguri në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me pakicë të karburanteve.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme për pajisjen me licencë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për praktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4 të nenit të 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 40 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nga ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknike për realizimin e kontratës që konsiston në disponimin e stacioneve të tregëtimit të karburantit duke qënëse objekti i kontratës është furnizimi me karburant i automejteve të AK gjatë lëvizjes së tyre në territor.

Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL, është kërkuar në mënyrë që OE të ketë aftësinë teknike për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi dhe shëndetit. Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), është kërkuar në përputhje me procedurat e lëshimit të Vërtetimit Teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nën produkteve të saj nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK). Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH është e rëndësishëm pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacion Shqiptar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe depozitat e tregtimit me shumicë që vërteton kapacitetet depozituese mbi 5 000 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në kushtet kur kemi të bëjmë edhe me furnizim me bot, furnizim i cili mund të ofrohet vetëm nga shoqëritë e tregëtimit me shumicë, duhet të paraqesë;

- a) Licencën përkatëse për tregtimin me shumicë të karburantit, objekt prokurimi,
- b) Vërtetim Teknik të lëshuar nga organet e miratuara të vlerësimit të Konformitetit (O.M.V.K.),
- c) Leje Mjedisore të tipit B (sipas shtojcës 1 të ligjit 52/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar),
- d) Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga M.Z.SH, dhe
- e) Policë Sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me shumicë të karburanteve.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) e V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të V.K.M. Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për praktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknike për realizimin e kontratës që konsiston në disponimin e stacioneve të tregëtimit të karburantit duke qënëse se objekti i kontratës është edhe furnizimi me karburant i pikave të transmetimit të antenave nëpërmjet botit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese flete-analiza të lëshuar nga I.SH.T.I., për Gazoilin D1 dhe Benzinën pa plumb, të cilat duhet të jenë lëshuar brenda brenda 6 muajve te fundit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 pika 6 gërma c,) të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, V.K.M. nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, V.K.M. nr. 147 datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, Benzinë dhe Diesel”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucioni i autorizuar I.SH.T.I. (e cila është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës) dhe që vërteton pajtueshmërinë e parametrave cilësorë të karburantit me specifikimet teknike të shtojcës 6 të D.T.

Lidhur me afatin e lëshimit të raportit të analizimit të karburantit nga strukturat e autorizuar, jemi referuar parashikimit të Urdhrit nr. 6 datë 9.01.2015 “Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat”, i ndryshuar, të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, pika II/4/c.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira të paktën 1(një) autobot të transportit të lëndëve të rrezikshme me kapacitet mbartës jo më pak se 500 (pesëqind) litra për furnizimin sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Autoboti duhet të jenë pajisur me Leje Qarkullimi, Kolaudimi Teknik i automjetit, police sigurimi, çertifikate për transportin e mallrave të rrezikshme dhe pasaporta e mjetit lidhur me kapacitetin mbartës të karburantit.

Argumentim: Bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në nenin 40, pika 5, gërma “ç”, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ligjin nr.8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimin nr.15, datë 24.007.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik fitues i kësaj procedure prokurimi me kërkesë të Autoritetit kontraktor ALBCONTROL do të bëjë furnizimin me lëng për të gjitha pikat ku ALBCONTROL disponon rezervuar naftë, sipas kërkesës së ALBCONTROL tek Specifikimet Teknike – Shtojca 6 në D.T., dhe për këtë qëllim duhet të jetë i pajisur me një autobot me kapacitet minimal 500 (Pesëqind) litra.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratat si më poshtë:

- Duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritet kontraktore, me tollon ose lëng, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant nëpërmjet autobotëve në pikat:
 - Porto Romano (Reparti Ushtarak pranë radarit të ALBCONTROL).
 - Sari Salltik (Reparti ushtarak Mali Krujës).
 - Stacioni i antenave në Kaninë (Vlorë)
 - Aeroporti i Vlorës
 - Ambientet e Kullës së ALBCONTROL / Rinas.
 - Ambientet e Administratës ALBCONTROL / Rinas.
 - Ambientet e Akademisë ALBCONTROL / Rinas.

Shënim: Për furnizimin me lëng për pikën e Sari Salltikut (Mali i Krujës), nafta (diesel) duhet të jetë naftë dimërore (diesel winter) klasa E-F.

- Duhet të deklarojë, se merr përsipër që të konvertojë të gjitha tollonat në lëng, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoriteteve kontraktore. Tollonat duhet të jenë pa skadencë dhe të konsumueshëm edhe gjatë vitit 2026.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma “ç”, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues ALBCONTROL SH.A. në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të A.P.P. dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT